

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, mr.sc. Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës “H.” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A. L., av. nga Prishtina, kundër të paditurës TEB sh.a. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Vlora Osmani, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 34.250 €, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.203/2016 datë 22.2.2018, dhe ankesës kundër aktvendimit Ae.nr.203/2016 datë 22.2.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 6.6.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.203/2016 datë 22.2.2018.

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, paraqitur kundër aktvendimit Ae.nr.203/2016 datë 22.2.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.203/2016 datë 22.2.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.06/2014 datë 4.4.2016, me të cilin është refuzuar në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar sipas kontratës në shumë prej 34.250 €, me kamatë ligjore në lartësi prej 3.5% si për mjetet e deponuara duke filluar nga 31.10.2011 e

deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Është vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore t'i bartin secila palë veç e veç.

Me pjesën I të aktvendimit Ae.nr.203/2016 datë 22.2.2018, avokatit A. L., nga Prishtina, i është shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 300 €, për shkak të fyerjes së gjykatës me ankesën e datës 10.5.2016, e cila gjobë duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, në llogarinë bankare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e nëpërmes arkës së kësaj gjykate. Me pjesën II të dispozitivit është vendosur që nëse avokati A. L., nuk e paguan gjobën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu i cili zgjatë në proporcion me lartësinë e gjobës së caktuar, ashtu siç është përcaktuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, por jo më shumë se një muaj. Me pjesën III të dispozitivit është cekur se ankesa nuk e ndalë ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi ka paraqitur revizion ndërsa kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës ka paraqitur ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni si i bazuar, ashtu që lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

E paditura ka paraqitur përgjigje në revizion me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar ndërsa aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të vërtetohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 dhe nenit 194 lidhur me nenin 208 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi tek e paditura TEB ka pasur të hapur xhirollogarinë rrjedhëse dhe ka afatizuar një shumë të hollave për një vit. Me kërkesën e paditësit është prishë kontrata e afatizimit të mjeteve dhe një pjesë janë transferuar në PCB e gjysma tjetër në NLB, me seli në Prishtinë. Fletë transferimi është nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i paditësit Sh.J., Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut P.nr. 330/2012 datë 2.8.2012 dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr. 477/2012 datë 30.12.2012i, akuzuari Sh. J., i cili ka

përfaqësuar paditësin në transferimin e të hollave, është shpallur fajtorë për veprën penale përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës në vazhdimësi, nga neni 340 par.3 i Kodit Penal të Kosovës dhe i njëjti është obliguar që paditësit t'ia kthejë shumën prej 78.452, 30€, në afat prej një viti nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Paditësi me padinë e parashtruar ka kërkuar që në emër të kompensimit të dëmit, për shkak se njëanshëm e ka shkëputur kontratën mbi afatizimin e mjeteve të deponuara dhe i ka mundësuar punëtorit Sh. J.(kontabilist tek paditësi) që me falsifikim të tërheqë në vazhdimësi të hollat e paditësit nga xhirollogaria, të obligohet e paditura t'ia paguaj shumën prej 34,250,00 €, me kamatë ligjore prej 3,5% duke filluar nga 31.10.2011.

Gjykata e shkallës së parë në këtë gjendje të vërtetuar faktike, ka konstatuar se paditësi e ka pësuar dëmin nga punëtori i saj – Sh. J., i cili në mënyrë të kundërligjshme e ka përvetësuar shumën prej 78.452,30 €, ku bënë pjesë edhe shuma e kërkesëpadisë së paditësit, e të cilën shumë është obliguar t'ia kthejë paditësit, andaj ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës, në tërësi ka aprovuar gjetjet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Pretendimin e paditësit të cekur në revizion se hyrja, dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit janë në kundërshtim njëra me tjetrën, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase në revizion nuk ceket se në cilën pjesë të aktgjykimit janë kundërthëniet e pretenduara. Faktin e cekur se për tu prishur kontrata sipas nenit 4 të kontratës, lidhur me afatizimin e të hollave, është dashur të bëhet kërkesa dhe të njëjtën ta nënshkruaj drejtori i H.–it, Gjykata Supreme e Kosovës e shqyrtoi, por një pretendim i tillë nuk ka vënë në dyshim ligjshmërinë e aktgjykimit të kundërshtuar, ngase, me të drejt gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar se paditësi nuk ka ofruar bazën juridike për të mbështetur kërkesëpadinë, ndërsa dëmi

paditësit i është shkaktuar me veprimet e kundërligjshme të punëtorit të saj, për të cilat i njëjti është gjykuar sipas aktgjykimeve të cekura më lartë dhe është obliguar që paditësit t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar.

Në revizion nuk është cekur asnjë dispozitë ligjore se ku qëndron zbatimi i gabuar i të drejtës materiale në aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe me asnjë pretendim konkret nuk është vënë në dyshim ligjshmëria e aktgjykimit të kundërshtuar, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 136 par. 1 të LMD –ës kur ka konstatuar se për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet të përmbushen kushtet e përgjegjësisë: të ekzistojë përgjegjësia e të paditurit, fakti dëmtues nga rrjedhë dëmi, të ekzistojë dëmi i shkaktuar, lidhja shkakësore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar dhe kundërligjshmëria e veprimit me të cilin është shkaktuar dëmi. Ndërsa, neni 138 i LMD –ës parashikon obligimin për kompensimin e dëmit vetëm kur vërtetohet se dëmi është shkaktuar me fajin e dëmtuesit dhe në qoftë se i dëmtuari ka ndërmarrë veprime për parandalimin e dëmit ose zvogëlimin e tij.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, ngase llogaria e paditësit për depozitat me afat është shkëputur sipas kërkesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, ndërsa në veprimet e të paditurës nuk janë gjetur shkelje, sepse asaj i janë prezantuar fletë transferet dhe autorizimet e nënshkruara dhe të vulosura nga personi i punësuar tek paditësi.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pabazuar pretendimi i cekur në ankesën e parashtruar kundër aktvendimit Ae. nr.203/2016 datë 22.2.2018, për shqiptimin e dënimit me gjobë avokatit A.L., në shumën prej 300€, se i njëjti nuk ka fyer rënd gjykatën e shkallës së parë, sepse në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ekzistojnë fjalët fyese të cilat i ka përdorur avokati në rastin konkret, andaj, vendimi i cekur i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i drejt dhe i bazuar në ligj. Me ankesë me asnjë pretendim konkret nuk është vënë në dyshim ligjshmëria e aktvendimit të kundërshtuar, andaj ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 288.1, 289.1 dhe 294 të LPK –ës, të cilat nene kanë përcaktuar dënimin me gjobë nëse gjatë zhvillimit

të procedurës përfaqësuesi ligjor ose ai me prokurë me veprimet e tyre i keqpërdorin rëndë të drejtat të cilat u janë njohur me ligj, andaj pretendimet e cekura u vlerësuan si të pabazuara.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222, nenit 195.1 lidhur me nenin 209 pika (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjegjësisht aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

E.Rev.nr.18/2018 datë 6.6.2018

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku